



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 12.10.2018,  
e cila filloj në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkyetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Visare Gashi (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fikneta Bejta (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Florida Canolli (PDK), Sokol Berisha (AAK), Ylli Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Dëri (AKR-AA) dhe Bukurie Canolli (LB).

Munguan: Baton Dushi (Nisma) dhe Uran Ismaili (PDK).

Të pranishëm ishin edhe drejtore të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit.

Ai hapi diskutimin përendin ditës.

Rifat Dëri tha se në mbledhjen e parafundit jemi pajtuar që në rend të ditës të futet edhe formimi i Komisionit për emërtimin e institucioneve dhe rrugëve në komunën e Prishtinës, dhe propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të futet nën pikën e dytë të rendit të ditës.

Agim Gashi theksoi se pika e dytë duhet të riformulohet, sepse nuk është në përputhje me materialin që kemi, sepse nuk është njësoj informata dhe raporti.

**Egzon Azemi** propozoi që rruga "Çlirimi", të emërtohet, rruga "Arbënor dhe Astrit Dehari", ndërsa parku afër rrugës "Bahri Fazliu", të emërtohet Parku i Çlirimt.

**Eman Rahmani** propozoi që pika e 13-të e rendit të ditës "Pjetje dhe përgjigje", të jetë pikë e tretë e rendit të ditës, ndërsa pika e propozuar nga Egzon Azemi, të jetë pikë e dytë e rendit të ditës.

**Halim Halimi** u shpreh se pika që ka të bëjë me raportin finansiar, për ne si grup parlamentar nuk ka kurrfarë efekti, por kjo pikë është dashur të jetë diku në korrik ose, më së largu në gusht, dhe nëse shkojmë kështu siç kemi filluar, atëherë raportin nëntëmuajor na bie ta shqyrtojmë në vitin e ardhshëm.

**Fatos Dibra**, përfaqësues i Zyrës ligjore, theksoi se sa i përket emërtimit të rrugëve, ndryshimet dhe plotësimet mund të bëhen përmes peticionit të qytetarëve dhe ai emër që propozohet mund të merret nga lista rezervë, që ka vlefshmëri 5-vjeçare, e miratuar në Kuvendin e Komunës. Mendoj se Kuvendi mund të vendosë që kjo të futet si pikë në rend dite për shqyrtim.

**Kryesuesi** tha se sa i përket propozimit të z. Deri, do ta shqyrtojmë, në mënyrë që në mbledhjen e radhës ta shohim mundësinë që ta fusim si pikë të rendit të ditës.

**Shefki Gashi** tha se me Ligjin e administrimit të pushtetit lokal, të gjitha komisionet dhe komitetet përfundojnë me përfundimin e mandatit të Asamblesë, pra me mandatin e Asamblesë përfundojnë edhe zgjidhen komitetet dhe komisionet ndihmëse të Kuvendit të reja, që do të thotë, atë që kërkoi z. Deri, është obligim i Kuvendit me e formuar komisionin e ri.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se do të ishte mirë që të fillohej me caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve. Ka nevojë edhe ashtu me u shqyrtuar, me u ndryshuar, por të shkojmë me një parim institucional që na shërben të gjithëve, jo njëanshëm, jo pse dikush e ka një përvjetor e tash të qohemi me ia kthyer amanetin se ia kanë borxh, por të shkojmë në formë institucionale.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, theksoi se është mirë dhe e drejtë e Kuvendit dhe e këshilltarëve, me dhënë propozime të ndryshme, por kërkoi nga Zyra ligjore që, deri në mbledhjen e radhës së Kuvendit, ta bëjë një interpretim të procedurave ligjore për emërtimin e rrugëve. Si ekzekutiv nuk kemi të drejtë të emërtojmë rrugë as sheshe, por i përkrahim në parim si iniciativë për këto ndryshime.

**Sami Boroci** e përkrahu propozimin e Egzon Azemit, mirëpo tha se ekzekutivi do të duhej që konform kompetencave të veta, të krijojë një komision, i cili do ti përcaktonte dhe harmonizonte kërkeshat. Pra, do të ishte mirë të dihet procedura më e mirë ligjore se si të arrinte deri në Kuvend propozimi i Egzonit.

**Nol Nushi**, në emër të GP të PSD-së, shprehu përkrahje për ndryshimin e emrit të rrugës "Çlirimi" dhe emërtimin e saj, rruga "Astrit Dehari".

**Blerand Stavileci** tha se sa i përket emërtimit të rrugëve, do të ishte mirë që të vendoset ashtu si e parashesh ligji, pra themelohet komisioni, i cili mund të jetë i përzier, ku mund të marrin pjesë të gjithë, edhe ekspertë, edhe njerëz të fushave të ndryshme që mund të kontribuojnë në këtë drejtim.

**Ardian Olluri**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, tha se emërtimi i rrugëve është kompetencë e Kuvendit të Komunës, andaj mendoj që Kuvendi mund të vendosë për emërtimin e një rruge të caktuar, edhe me ia ndryshuar emrin, nuk besoj që ka ndonjë pengesë ligjore.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Egzon Azemit.

**Kryesuesi** konstataoi se më 32 vota për, 5 kundër dhe 2 abstenime, futet në rend dite për diskutim propozimi për emërtimin e rrugës "Arbënor dhe Astrit Dehari".

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, bëri të ditur se ekzekutivi nuk ka as kompetencë, as autorizim që të vendosë se cila kërkesë është më me prioritet, por do të ishte mirë që të formohet një komision, sepse, realisht, nuk po duam ne me vendosur se cila rrugë është më e rëndësishme, apo cili emër është më i rëndësishëm se tjetri, sepse mund të jemi subjektiv.

Për kërkesat që u parashtruan nga parafolësit rreth formimit të një komisioni për emërtimin e rrugëve, kryesuesi tha se për mbledhjen e radhës së Kuvendit, kërkoj nga Zyra ligjore një interpretim ligjor me shkrim.

**Naime Osmani** u shpreh në përkrahje të propozimit të z. Deri, për formimin e një komisioni për emërtim të rrugëve dhe riemërtimin e tyre. Ajo propozoi që ky komision ta ketë parasysh emërtimin e një rruge me emrin e një dëshmori të komunës së Prishtinës, Sabit Lahu, i zhdukur, nga fshati Rimanishtë, ka qenë luftëtar dhe ish-bashkëpunëtor i Zahir Pajazitit.

**Migjen Shala** shprehu mendimin se prej se ekziston Komuna e Prishtinës, komision më të dobët për emërtime të rrugëve nuk ka pasur. Ai u shpreh në përkrahje të propozimit të z. Deri për formimin e një komisioni dhe futjen e kësaj pike në rend të ditës. Si shembull mori fshatin Trudë, ku asnë emër i heronjve nuk gjendet në rrugët e këtij fshati, madje aty ka emërtime të rrugëve me emra sllavë, dhe për mua ky komision ka qenë antikombëtar. Me gjendje të jashtëzakonshme, vetëm për atë që e ka statusin e heroit ka të drejt me u marr Kuvendi edhe urgjentisht me vendos, pra për t'u ndërruar emri, duhet pasur një titull ai person nga institucionet e Kosovës. Emërtimet e rrugëve që janë me karaktere kombëtarë, kurrsesi nuk duhet ndërruar.

**Ardian Olluri** u shpreh se unë as nuk kam qenë anëtar i atij komisioni, as nuk kam qenë drejtor i Urbanizmit në atë kohë. Anëtarë të atij komisioni kanë qenë përfaqësuesit e të gjitha

subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, duke përfshirë edhe PDK-në.

**Kryesuesi e hodhi në votim propozimin, që pika "Pjetje dhe përgjigje" të jetë pikë e dytë në rendin e ditës.**

**Kryesuesi konstatoi se më 5 vota për, 25 kundër dhe 2 abstenime nuk u miratua ky propozim.**

**Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, me propozimin e z. Agim Gashi, që në vend të fjalës "informatë" të jetë "raport", dhe pika e propozuar nga z. Egzon Azemi të jetë pikë e dytë e rendit të ditës.**

**Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për dhe 2 abstenime, u miratua ky**

#### **REND I DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë dhe tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Çlirimi" në emërtimin "Arbënori dhe Astrit Dehari" dhe emërtimin e parkut afér rrugës " Bahri Fazliu" , me emrin Parku i Çlirimt;
3. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 prill - 30 qershori 2018, (TM2);
4. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2017;
5. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit komunal të NPL "Pallati i Rinisë";
6. Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës;
7. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK);
8. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP);
9. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhmi (Nezir) Kastratit dhe Aza (Miftar) Hasanajt;

- 11. Informatë për suksesin dhe rezultatet e arritura të nxënësve në arsimin parauniversitar gjatë vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2018/2019;**
- 12. Informim mbi punën e aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB) dhe NPL "Hortikultura";**
- 13. Pyetje dhe përgjigje;**
- 14. Të ndryshme.**

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë dhe të tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

Egzon Azemi u shpreh se nuk kam ndonjë vërejtje rreth hartimit të ekstraktit, mirëpo vërejtja ime ka të bëjë me mungesën e pjesëmarrje në seancat e Kuvendit të asamblistik Uran Ismaili, i cili ka munguar në 4 seanca radhazi, e që ligji i interpreton shumë qartë, se dikush që mungon në 3 seanca radhazi i humbet mandati i këshilltarit. Andaj, kërkoj nga Zyra ligjore që ta interpretojë këtë çështje dhe të marrë vendim për këtë çështje Kuvendi komunal.

**Kryesuesi tha se** është detyrë e asamblistikit ta njoftojë kryesuesin në rast se mungon dhe unë kam njoftimin që z. Uran Ismaili ka qenë në udhëtim zyrtar.

**Agim Gashi** bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se në diskutimin tim lidhur me analizën e planifikimit të projektbuxhetit për vitin 2019 dhe kornizën afatmesme buxhetore, ku është përdorur fjala "keqplanifikim", është eliminuar nga hartuesi i procesverbalit, andaj kërkoj që ta përmirësojnë këtë.

**Fikneta Bejta** bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së shtatë, duke thënë se në vend të fjalës "Hertica" është shkruar "Reçica", andaj kërkoj që kjo të përmirësohet.

**Blerand Stavileci** tha se mungesat për pjesëmarrje në seanca janë të precizuara shumë mirë me ligje, andaj pse të politizohet kjo çështje kur shihen arsyet e mungesave!

**Nol Nushi** theksoi se ne jemi për votimin e ekstraktit, që është përbledhja në pikë të shkurtra e asaj që është diskutuar në mbledhjen e kaluar, cilat vendime janë marrë, cilat janë votuar, cilat nuk janë votuar, cilat janë shtyrë për mbledhjen e ardhshme etj.

**Më 33 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratuan ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë dhe të tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

## Pika e dytë

Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Çlirimi" me emërtimin "Arbënor dhe Astrit Dehari" dhe emërtimin e parkut afër rrugës "Bahri Fazliu", me emrin Parku i Çlirimt.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Nol Nushi tha se vdekjet e tyre nuk janë as përafërsisht të njëjta, dhe në rrethana të njëjta, dhe për me ia ruajtur cilësimet Astritit, i cili ka vdekur në burg duke i kundërshtuar dy marrëveshje shumë të dëmshme për Kosovën, mendoj që duhet me mbetur vetëm emri i Astrit Deharit.

Egzon Azemi tha se këto dy raste të vrasjeve, në bazë të dëshmive cilësohen si vrasje politike dhe si të tilla duhet të trajtohen.

Sami Boroci kërkoi që kjo temë, ose emri i këtyre të dyve mos me u politizuar kaq shumë, se aq ultë është politizuar dhe është përdorur në të kaluarën, sa që sinqerisht është për të të ardhur keq për këtë situatë.

Eman Rrahmani theksoi se propozimi si pikë e rendit të ditës, prej Egzonit ka ardhur, me iu ndërruar emri dhe me u emërtuar Arbënor dhe Astrit Dehari, nuk ka ardhur vetëm Astrit Dehari.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë propozimvendim.

Kryesuesi konstatoi se me 25 vota për, 6 kundër dhe 2 abstenime u miratua Vendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Çlirimi" me emërtimin "Arbënor dhe Astrit Dehari" dhe emërtimin e parkut afër rrugës " Bahri Fazliu", me emrin Parku i Çlirimt.

## Pika e tretë

Raporti për gjendjen financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershori 2018 (TM2).

Kryesuesi hapi diskutimin.

Lidhur me Raportin për gjendjen financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershori 2018 (TM 2), në pikë të shkurtra të pranishmit i njoftoi Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave.

Agim Gashi tha se shqyrtimi i raportit finanziar buxhetor të Komunës së Prishtinës për këtë periudhë në muajin e dhjetë, nuk prodhon ndonjë efekt ndikues në përmirësimin e gjendjes në qeverisje, edhe pse duket shumë i parëndësishëm. Në këto tabela buxhetore janë dhënë informacione jo të sakta, edhe ju lus që mos të përsëritet kjo metodë, sepse kjo nuk ju sjell

ndonjë të mirë, por as neve si asamblistë, sepse nuk na krijon kushte që ne t'i vlerësojmë punët ashtu siç janë bërë, ashtu siç dalin nga rezultatet e prezantimit statistikor në dokumentet e prezantuara.

Sa i përket edhe të hyrave, atje shihet se trendi gjashtëmujor është mjaft i ulët, pra këto statistika flasin se gjendja e të hyrave nuk është duke shkuar mirë dhe nuk është në rregull. Po ashtu, janë edhe disa fusha të tjera atje, si shfrytëzimi i hapësirave publike, të hyrat nga hapësirat publike etj., që duhet të ndryshohen politikat e arkëtimit të atyre mjeteve dhe të përmirësoset gjendja, sepse në fund do të na dalë një gjendje jo e mirë.

**Fiknete Bejta** tha se në bazë të një analize, kam vërejtur se performanca financiare e Komunës së Prishtinës tregon rezultate jo të kënaqshme për ne asamblistët, por edhe për qytetarët. Në këtë gjashtëmujor ka mosrealizim, ose mossħpenzim të buxhetit sipas projekzionit financiar, me një tendencë që në fund të vitit kemi një suficit prej 10%, rrëth 10%, si te mallrat dhe shërbimet, ashtu edhe për paga dhe mëditje. Te shpenzimet kapitale, edhe pse kalkulimi sipas Drejtorisë së Financave është një lajthitje, sepse nuk ka Komuna buxhet 72 milionë, por është një shifër tjetër. Te të hyrat vetanake kemi një rënie tek disa kode buxhetore, që nuk ka arsyë të ketë rënie, aty është dashur të ketë trend rrëtës.

Po ashtu, shqetësues është edhe arkëtimi më i vogël nga taksat për shfrytëzim të mjeteve nga shfrytëzimi i hapësirave publike, nga 124 mijë e 903 euro ka rënë në 96 mijë e 906 euro.

Gjithashtu, ka ulje të donacioneve, sepse Komuna nuk po arrin të realizojë performancë të shkëlqyeshme, që organizatat e tjera, si DEMOS-i ose Qeveria zvicerane të shpërblejë me donacione, siç është rasti me komunat tjera.

**Eman Rahmani** theksoi se në Komunën e Prishtinës ka stagnuar gjithçka, sidomos në investimet kapitale, mirëpo, fatkeqësisht, edhe në sektorët tjerë nuk është gjendja më e mirë. Për t'i parë këto statistika edhe arsyet, ndoshta do të ishte më mirë që dikush nga ekzekutivi të na tregojë se a posedon Komuna plan të prokurimit për vitin 2018 dhe nëse po, ku mund ta gjejmë këtë plan të prokurimit.

Sa i përket të hyrave në tremujorin e dytë, këtu është cekur edhe më herët, mirëpo taksat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, do të thotë nëse e shohim vitin 2016, ka qenë 487 mijë e 407 euro, e në vitin 2018 është 96 mijë e 996 euro në të njëjtën periudhë kohore.

Kjo është një shifër tmerruese, kur e dimë të gjithë që hapësirat publike vetëm se janë shtuar, e që shfrytëzohen tash me leje apo pa leje. Edhe taksat për shfrytëzimin të sipërfaqeve publike janë në rënie. Në investimet kapitale deri tash janë mbi 8 milionë euro bartje, që janë bartur në seancën e kaluar, dhe as bartja në bazë të këtij ritmi qysh ka filluar nuk do të mund të shpenzohet gjatë këtij viti, që do të thotë 100% e buxhetit të investimeve kapitale do të duhet të bartet në vitin e ardhshëm.

Të gjitha këto tregojnë për një performancë jo të mirë, ku po vërtetohet nga të gjitha, edhe nga organet mbikëqyrëse të Kuvendit, siç është INPO. Tash ishte edhe një raport i GAP-së, ku tregon se nga 86-87 premtimet, për këtë vit nga kryetari janë realizuar vetëm gjashtë prej tyre. Po ashtu, janë edhe shumë projekte të tjera që janë premtuar dhe nuk janë realizuar gjatë kësaj periudhe.

**Arbenita Murseli** lidhur me projektet e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, në veçanti projekti për zgjerimin dhe modernizimi e rrjetit të ndriçimit publik, ku në tremujorin e dytë janë shpenzuar rreth 109 mijë euro. Në seancat e para unë kam parashtruar kërkesa për shtrirjen e ndriçimit në lagjen "Mati 1", përkatesisht në rrugën "Tasim Elezi", dhe në fshatin Tenezhdoll, ku banojnë afér treqind banorë, dhe si rrjedhojë asnijëra nga këto dy kërkesat nuk është plotësuar, edhe pse një shumë e konsiderueshme është shpenzuar. Tek ndërtimi i vendkalimeve për këmbësorë, pritoret (kabinat) e autobusëve dhe rregullimi, gjithsej janë në dispozicion 80 mijë euro, duke pasur parasysh që pritoret e autobusëve janë shumë të nevojshme për qytetarë.

**Vlora Dumoshi** kërkoi të dijë se me cilat shërbime merret Drejtoria e Shërbimeve Kulturore, sepse këtu buxheti për këtë tremujor është fare pak i ulët nga realizimi i paraparë, por tash e kemi gjendjen tjetër, se jemi në muajin tetor e këtu flitet për kohën deri në muajin prill.

**Adrian Berisha** tha se të gjitha drejtoritë janë të barabarta sa i përket ndarjes së buxhetit, andaj kërkoj që të gjitha këto të gjykohen pa ndonjë dallim dhe në mënyrë sa më objektive.

**Kryesuesi e hodhi** në votim raportin financiar.

**Kryesuesi** konstatoi se më 15 vota për, 12 kundër dhe 5 abstenime, u miratua Raporti për gjendjen financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2018 (TM 2).

**Pika e katërt**

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2017.

**Kryesuesi** hapi diskutimin.

**Halim Halimi** tha se Raporti i auditimit financiar për Komunën e Prishtinës për vitin 2017, sipas auditorit të përgjithshëm, ka një varg çështjesh të gjetura, për të cilat mund të thuhet se janë shkelje. Nëse nisemi nga faqja së parë, auditori ka dhënë një opinion, d.m.th. opinioni i auditorit është i pamodifikuar, me theksim të çështjes.

Nëse nisemi nga shpenzimet përmallra dhe shërbime, ka qenë shuma prej 1 milion e 823 mijë e 24 euro, janë realizuar dhe reportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Pra, pjesa më e madhe kanë qenë të rapportuara gabimisht, d.m.th. te investimet kapitale.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit te projektet kapitale për Komunën e Prishtinës, gjithmonë është sfidë kryesore, për shkak se vetëm 57% të buxhetit të Komunës është realizuar për këto investime kapitale. Nëse e analizojmë më mirë, nuk del që është as 57%, ngase këtu janë llogaritur disa mjete të cilat nuk është dashur të llogariten.

Të hyrat, shpenzimet dhe llogaritë e arkëtueshme, auditori ka konstatuar se janë pa kontrollim, nuk është bërë ndonjë kontrollim i brendshëm nga auditorët e brendshëm.

Rekomandimet nga vitet e kaluara dhe viti paraprak, nuk janë përbushur nga Komuna, d.m.th. obligim i Komunës ka qenë që të bëjë një plan të veprimit dhe rekomandimet, gjetjet nga vitet paraprake t'i sanojë.

Aktiviteti i auditmit të brendshëm nuk është funksional, d.m.th. auditimi i brendshëm edhe pse ekziston si Njësi e auditimit të brendshëm, aktiviteti i tyre, puna e auditorëve të brendshëm në Komunën e Prishtinës nuk shihet fare. Po të punohej në atë drejtim, atëherë nuk do të vinim në pozitën që Zyra e Auditorit të gjejë 26 të gjetura apo shkelje ligjore.

Po them se 43% e buxhetit në investimet kapitale, auditori ka konstatuar se janë shpenzuar kryesisht në tre muajt e fundit. Kjo paraqet një tregues se te projektet kapitale ka vonesa, si në kryerjen e punëve, ashtu edhe në procesin e prokurimit publik, kështu që janë shumë e shumë të gjetura të auditorit që tregojnë se Komuna nuk është duke punuar në bazë të rregullativës financiare.

**Fiknete Bejta** tha se sipas Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, është konstatuar se në menaxhimin e Komunës së Prishtinës ekzistojnë shumë mangësi sa i përket qeverisjes brenda Komunës. Veçanërisht në lidhje me mos zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak, anashkalimin e planit për menaxhimin e rrezikut, mungesë iniciativash konkrete në rritjen e të hyrave dhe mos efikasiteti i auditimit të brendshëm, si katalizator i efikasitetit të kontrolleve të brendshme. Në planifikimin dhe realizimin e buxhetit, ku ka mangësi të theksuara, sidomos tek projektet kapitale, ku si pasojë e kësaj kemi mungesë të 43% të realizimit të buxhetit për këtë kategori. Nga 25 të gjeturat, apo theksime të çështjeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit, do të veçoja lidhjen e kontratave dhe vonesën në realizimin e tyre, planifikimin jo të mirë të të hyrave, mos realizimin e të hyrave nga shfrytëzimi i pronave, d.m.th. Komuna e Prishtinës e jep pronën komunale për subjektet afariste ose fizike pa ndonjë kompensim etj. Nivel i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale, është rrjedhojë edhe e këtyre problemeve ose mangësive, sepse me këto po krijohet baza për mos planifikim të mirë. Pra, Zyra Kombëtare e Auditimit ka theksuar si çështje ose si problem në Komunë, mos planifikimin e mirë, d.m.th. nuk kanë planifikim. Nga kjo del se Kryetari i Komunës, Zyra e brendshme e auditorit nuk ka ndonjë plan operativ për trajtimin e të gjeturave nga ZKA-ja.

**Leonora Shabani - Bajraktari** theksoi se të gjeturat nga Zyra Kombëtare e Auditorit për Komunën e Prishtinës janë shumë shqetësuese, sepse nuk janë marr me seriozitet rekomandimet e auditorit nga Kryetari i Komunës. Auditori i jashtëm edhe në vitet paraprake ka ofruar rekomandime për Kryetarin e Komunës dhe ato vazhdojnë të mos përfille, gjë që është jashtëzakonisht shqetësuese.

**Shefqet Osmani** kërkoi të dijë se standartet e auditorit a janë të dyfishta, apo ka ndikuar politika, se në çoftë se e merr dhe e lexon një raport të auditorit për Komunën e Malishevës, thuhet se shpenzimet e 28 rasteve, me vlerë 176 mijë euro, të cilat gjithashtu për nga natyra i përkasin mallrave dhe shërbimeve, ishin paguar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e

investimeve kapitale 176 mijë euro edhe është e kualifikuar, ndërsa në Komunën të Prishtinës të njëtin rast, i ke 1 milion e 823 mijë euro.

Diçka këtu nuk është në rregull, a ka ndikuar politika apo kryetari?!

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Shefqet Osmani, Osman Bllaca dha sqarime të nevojshme.

**Agim Gashi** theksoi se ky raport nuk është më i mirë i mundshëm i ardhur në Komunën e Prishtinës. Komuna e Prishtinës për shkak të punës së mirë që ka bërë në periudhat e kaluara, ka marrë miliona euro donacione dhe ajo është bërë si rezultat i një qeverisje të mirë, sepse asnjë donator nuk i referohet Komunës së Prishtinës në çoftë se nuk qeveris mirë. Tani këto donacione veç janë në rënien. Po ashtu, janë bërë shkelje edhe në institucionet edukativ-arsimore etj., andaj kërkoj që raporti i vitit të ardhshëm të mos na gjejë në këtë nivel, sepse nuk janë shkelje të vogla 26 raste që i identifikon auditori. Ai na këshillon dhe ne duhet të marrim masa përmirësim.

**Bashkim Beha** u shpreh se të gjeturat që janë në këtë raport janë të gjetura, por duhet të merren si sugjerime për ta përmirësuar performancën financiare, por nëse këto do të ishin shkelje ligjore aq të mëdha, atëherë besoj se komplet ekzekutivi do të kishte përfunduar në Prokurori. Sido çoftë, opinioni i pamodifikuar tregon që pasqyrat paraqesin gjendjen reale dhe gjendjen e drejtë të tyre. Është e vërtetë se ka shumë çështje të theksuara, që besoj se ekzekutivi do të merret me to, meqenëse mbi të gjitha ne i raportojmë qytetarëve të Prishtinës dhe ata duhet ta kenë këtë raport sa më të drejtë dhe më në rregull.

**Ardian Olluri** tha se kur është marrë qeverisja e Komunës nga Shpend Ahmeti, e ka gjetur zero pasuri të regjistruar. Sot kemi arritur dy të tretën me e regjistruar, dhe besoj se shumë shpejt do të arrijmë me e regjistruar komplet. Përveç kësaj, e ka gjetur një gjendje të nepotizmit, ku nuk janë punësuar as partiakët, por familjarë të njerëzve që kanë qenë në pushtet dhe prej kësaj gjendje është kaluar në meritokraci. Besoj se Komuna e Prishtinës është institucioni që ka më së shumti merita për punësim me njerëzit me meritë gjatë këtyre viteve të fundit.

**Leutrim Retkoceri** tha se sipas të dhënave nga raporti, shihet se realizimi i mjeteve nuk është bërë në formë të duhur, do të thotë se nuk është një menaxhim adekuat që i bëhet financave. Ne kemi potencuar edhe herën e kaluar që kemi vonesa në realizimin e pagesave, e gjithashtu kemi vonesa edhe në kryerjen e punëve, ndërsa kemi një menaxhim po ashtu jo adekuat të personelit. Edhe te subvencionet, p.sh. e kemi edhe këtu të potencuar që raportimi dhe monitorimi i shpenzimeve të subvencioneve nuk paraqitet si duhet. Kjo është një mundësi për hapësirë për me e keqpërdorur, por shpresojmë se në ditët e ardhshme kjo do të përmirësohet me një shpejtësi më të madhe sesa ajo që jemi duke e parë në Komunën e Prishtinës.

Nëse e bëjmë edhe një krahasim te reporti, del në pah edhe një dobësi, në përgjithësi kjo është një qeverisje jo efikase. Ky report korrespondon me këtë, por shpresojmë që ato të përmirësohen.

**Pas të gjithave diskutimeve, Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2017.**

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit komunal të NPL “Pallati i Rinisë”.**

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Halim Halimi**, në emër të GP të LDK-së, për anëtar të Komisionit komunal të NPL “Pallati i Rinisë”, propozoj Shefqet Osmanin.

**Leonora Shabani - Bajraktari**, në emër të GP të LVV-së, për anëtar të Komisionit komunal të NPL “Pallati i Rinisë”, propozoj Egzon Azemin.

**Vala Peshku**, në emër të GP të PSD-së, për anëtar të Komisionit komunal të NPL “Pallati i Rinisë”, propozoj Mimoza Sylejmanin.

**Leutrim Retkoceri**, në emër të GP të PDK-së, për anëtar të komisionit komunal të NPL “Pallati i Rinisë”, propozoj Migjen Shalën.

**Kryesuesi i hodhi** në votim propozimet e dhëna.

**Kryesuesi konstatoi** këto votime: Shefqet Osmani 30 vota për; Egzon Azemi, 8 vota për; Mimoza Sylejmani, 19 vota për dhe Migjen Shala 7 vota për.

**Kryesuesi konstatoi** se anëtarë të komisionit komunal të NPL “Pallati i Rinisë”, u caktuan Shefqet Osmani dhe Mimoza Sylejmani.

**Pika e gjashtë.**

**Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës.**

**Kryesuesi konstatoi** se më 33 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Statuti i Muzeut të Prishtinës.

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi** për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës(BQK).

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Halim Halimi** tha se ne si grup parlamentar i LDK-së nuk jemi kundër dhënies së pronës komunale BQK-së, por jo me ia falur. Ne mund të bisedojmë për dhënien në shfrytëzim për një kohë të caktuar, 10 apo 20 vjet, por së paku me një mundësi te kompensimit, që Komuna të marrë një kompensim, ose BQK-ja ta ndihmojë Komunën materialisht për ndërtimin e ndonjë çerdheje, shkolle apo ndonjë objekti tjetër.

**Vala Peshku** tha se nëse një pronë jepet për 99 vjet në shfrytëzim, nuk e di si mund të konsiderohet pronë e falur! Ne kemi dhënë prona në shfrytëzim këtu edhe për institucionë të tjera publike dhe asnjëherë nuk e kemi pasur këtë problematikë, e cila tash ka lindur, vetëm pse në emrin e institucionit të cilit po ia japim në shfrytëzim ekziston një fjalë, e cila është "bankë". Ne si grup e përkrahim propozimvendimin për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone të paluajtshme të Komunës për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

**Mirsad Vitia** theksoi se pse të jepet në shfrytëzim për 99 vjet, kur ne si Komunë kemi problem me prona komunale dhe hapësira publike, kur dihet se edhe drejtoritë tona kanë mungesë të hapësirave të mjaftueshme.

**Fadil Gashi** shprehu mendimin se kjo dhënie e pronës në shfrytëzim është e gabueshme. Të jepet për 99 vjet pa asnjë kompensim, mendoj që nuk ka kuptim. Ne kemi dhënë edhe prona të tjera, por kjo praktikë duhet ndalur. Si grup parlamentar e përkrahim, por në praktika të tjera nuk do ta përkrahim.

**Sami Boroci** tha se kjo pikë duhet kaluar, sepse vetë ai objekt është i integruar brenda në hapësirat e BQK-së. Si grup ne e votojmë këtë propozimvendim.

**Adrian Berisha** u shpreh kundër dhënies së kësaj prone komunale për 99 vjet BQK-së dhe propozoi që kjo pronë të jepet për 10 vjet.

**Egzon Azemi** tha se ai objekt është pasuri shoqërore e Kuvendit komunal, mirëpo nuk është e regjistruar, pra nuk ka certifikatë të regjistrimit të këtij objekti.  
Nëse votohet ky vendim, MAPL-ja do ta kthejë si të kundërligjshëm.

**Leonora Shabani-Bajraktari** tha se në fakt BQK-ja nuk ka kërkuar që objekti t'i jepet për 99 vjet, andaj pse ne t'ia japim kur ata vetë nuk e kanë kërkuar.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës dhe Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit.

**Halim Halimi** tha se ne si GP i LDK-së propozojmë që objekti të jepet në shfrytëzim për 20 vjet.

**Me propozimin e dhënë nga GP i LDK-së, kryesuesi konstatoi se më 23 për, 3 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).**

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Mirsad Vitia**, në emër të GP të LVV-së, tha se në parim jemi që kjo pronë të jepet në shfrytëzim, mirëpo dëshirojmë të dimë pse pa kompensim, kur e dimë se kjo është e përcaktuar me rregullore, andaj çfarë përfitojnë qytetarët nga ky veprim nëse ne e japim pa kompensim?

**Vlora Dumoshi** tha se ne nuk mund të marrim vendimin aty për aty, me kërkuar që ata me kompensuar Komunën për tokën të cilën po e japim në shfrytëzim. Pra, duhet me qenë kërkesa që vjen në Kuvend, pastaj ne e miratojmë.

**Nol Nushi** tha se për institucione publike, nëse pajtohem me arsyetimin e kërkësës së tyre, nuk ka kuptim me kërkuar kompensim. Si shembull konkret marrim ndërtësën e Pallatit të Rinisë, që na e ka dhënë Qeveria pa kompensim, pra nëse i referohemi arsyetimit, vërehet qartë se për çka po kërkohet dhe mendoj që është në interes të qytetarëve kjo kërkësë.

**Vala Peshku** theksoi se ne ju kemi dhënë tokë në shfrytëzim për 99 vjet si Ambasadës amerikane, Policisë së Kosovës, KFOR-it etj., kështu që unë nuk e di se pse po eskalojmë në kësi propozimesh, kurse po krijojmë standarde të dyfishta brenda për brenda këtij kuvendi.

**Sami Boroci** tha se do të ishte mirë që të mos krijohen standarde të dyfishta dhe unë jam për ta votuar këtë propozimvendim.

**Eman Rahmani** tha se jemi që kjo pikë të kalojë, mirëpo të jepet me kompensim. Nuk po përdorim standard të dyfishtë, për shkak se këtë qëndrim e kemi prej fillimit të këtij mandati, duke filluar prej pronës për KEDS, që kemi kërkuar me u paguar e deri më tash për secilën pronë të dhënë publike kemi kërkuar që të jepet me kompensim dhe jo falas.

**Drilon Pireva** u shpreh se ne këtu të gjithë së bashku është dashur ta mbështesim se cilin vendim që qon drejt fuqizimit të publike.

**Fadil Gashi** u shpreh kundër dhënies së kësaj prone në shfrytëzim pa kompensim dhe kërkoj që kjo praktikë të ndalet.

**Visare Gorani - Gashi** tha se po t'i referohemi arsyeshmërisë së ARKEP-së, ka të bëjë vetëm me përmirësimin e shërbimeve të standardeve, prej të cilave përfitojnë pothuajse të gjitha institucionet që merren me sigurinë etj., andaj nuk ma merr mendja që do të duhej të kishte këtu ndonjë fitim Komuna, se fitimi është i të gjithë qytetarëve të Kosovës e jo vetëm të Prishtinës.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimvendimin.

**Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).**

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi** për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tëresinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje".

**Kryesuesi** hapi diskutimin

**Halim Halimi** tha se ne si GP i LDK-së, mendojmë se këto plane nuk mund të bëhen pa hartimin e Hartës zonale, d.m.th. kjo është e përcaktume në ligj. Për t'u bërë revidimi i planit rregullues, duhet domosdo të jenë edhe hartat zonale.

**Eman Rrahmani**, në emër të GP të LVV-së, tha se në parim do ta mbështesim këtë propozim, për arsyen që mos të pengohen qytetarët përvendime të kundërligjshme që ka marrë Qeveria në lidhje me këtë pjesë të qytetit. Drejtoria përkatëse tanë është dashtë që të jetë në fazën përfundimtare të hartimit zonal edhe Planit zhvillimor.

Ai kërkoi të dijë se kur do të përfundojë hartimi zonal dhe Plani zhvillimor, që me u zhbllokuar edhe lagjet e tjera.

**Shefki Gashi** tha se jemi për këtë pikë, por nuk është e drejtë që me mbetur peng qytetarët për hartën zonale, e cila është shfaqur disa kohë edhe këtu i kemi disa afate që i kemi aprovuar, prandaj unë i mbështes parafolësit që të vazhdohet me procedimin që proceset të shkojnë para.

Lidhur me vërejtët dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimvendimin.

**Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tëresinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje".**

## Pika e dhjetë

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhmi (Nezir) Kastratit dhe Aza (Miftar) Hasanajt.**

**Krysuesi hapi diskutimin.**

Lidhur me Propozimvendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhmi (Nezir) Kastratit dhe Aza (Miftar) Hasanajt, në pikë të shkurtra të pranishmit i njoftoi **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës.

**Shefki Gashi** tha se do të ishte mirë që këto propozimvendime për këmbimin e pronave të sqarohen më mirë, kështu që të mos biem ndesh me ligjin ose me rregulloret e punës.

**Fatos Dibra**, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se kur është kthyer kjo barrë hipotekare, kanë pasur tre ose katër pronarë të këtyre pronave, të cilët kanë pasur pëlqime bankare, por kanë pasur pëlqime për një procedurë tjetër, që ka qenë shpronësimi i pronës. Në ndërkohë pronarët e tjerë e kanë hequr prej barrës hipotekare komplet, kurse ka mbetur veç një prej bashkëpronarëve, z. Shemsedin Klaiqi, i cili e ka një barrë hipotekare për pronën e vet.

**Egzon Azemi** theksoi se arsyaja pse u largua kjo pikë në seancën e kaluar prej rendit të ditës, kanë qenë pikërisht këto barrat hipotekare, kështu që prapë nuk është e qartësuar saktësisht se cilat janë ato 19 metra kontestuese.

**Agim Gashi** tha se nëse ajo parcelë, prej 96 arë, nëse nuk është e paparcelizume, nuk mund ta bësh asnjë ndryshim, e as Kuvendi, pa pëlqimin e të gjithëve, prandaj mendoj se kjo pikë duhet të shtyhet deri në seancën e ardhshme, të sqarohen këto gjera.

**Sami Boroci** tha se unë personalisht nuk jam për ta bllokuar këtë proces, nuk e kisha votuar asnjë formë pa e parë pëlqimin bankar. Mendoj se në momentin që e kemi pëlqimin e bankës, nuk do të duhej të kishte problem.

**Adrian Berisha** theksoi se nga diskutimi shihet se mungon një koordinim i punëve mes Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Kadastrit, si dhe një mosbashkëpunim i ekzekutivit.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit dhe Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit.

**Kryesuesi** e hodhi në votim këtë propozimvendim.

**Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 9 kundër dhe 4 abstenime, nuk u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhmi (Nezir) Kastratit dhe Aza (Miftar) Hasanajt.**

*Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se përderisa kemi të bëjmë këmbim me pronën komunale, atëherë kjo nuk mund të kalojë, se në këtë rast nevojiten shumica e anëtarëve të Kuvendit, jo të anëtarëve të pranishëm, pra shumica që i bie 26 anëtarë.*

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

Informatë për suksesin dhe rezultatet e arritura të nxënësve në arsimin parauniversitar gjatë vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2018/2019;

Lidhur me Informatën për suksesin dhe rezultatet e arritura të nxënësve në arsimin parauniversitar gjatë vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2018/2019, të pranishmit i informoi Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

**Agim Gashi** tha se në bazë të raportit të prezantuar, suksesi mesatar vjetor për të tri nivelet del diku 3.80 nota mesatare, dhe është një sukses solid, mesatar, që flet për një arritshmëri reale, përkundër asaj që ne të gjithë nuk jemi të kënaqur me shkallën e arritshmërisë, sepse synojmë sa më lart të arrijmë.

Në këtë raport janë paraqitur vetëm emrat e institucioneve dhe nuk janë emrat e nxënësve të shkollave privatet, ndërsa për shkollat publike mungojnë numri i fëmijëve në institucione publike dhe ato me bazë në komunitet, mungojnë statistika etj. Të gjitha këto flasin se në raport mungojnë të dhënat statistikore për institucionet parashkollore dhe 1 deri në 5, dhe ato private, shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, që shkon shifra diku 7-8 mijë fëmijë dhe nxënës, dhe kjo do ta kishte begatu reportin. Komuna për 5 vjet nuk ka arritur ta ndërtojë një institucion, Prishtinës i mungojnë 7 objekte shkollore fillore dhe një e mesme, Shkolla e Muzikës. Për çështjet kadroovike, kur i realizojmë mungesat e fëmijëve, na mungojnë mungesat e mësimdhënësve, nuk i pasqyron rapporti mungesat e mësimdhënëseve. Po ashtu, ka pasur probleme në administratën komunale në dërgimin e mësimdhënësve, ku nëpër shkolla kanë munguar mësimdhënësit për shkak të pushimeve të lehonisë dhe obligimeve të tjera familjare që i kanë pasur etj.

**Leonora Shabani-Bajrakti** tha se për vitin shkollor 2018-2019 është cekur se janë ofruar trajnime për mësimdhënës, ku në fakt këto trajnime bëhen nga MASHT, por a është ndërmarrë apo mbështetur ndonjë iniciativë për zhvillimin profesional. Po ashtu, të dhënat për çerdhet nuk janë publike dhe nuk ka transparencë. Mungesa e transparencës gjithashtu vërehet gjatë punësimit të stafit me ndërhyrje për pranimin në punë. Kërkoj nga kjo drejtori që ndikojë pozitivisht, që stafi që do të merrej me fëmijë, sidomos të shkollave fillore, të jenë sa ma profesionalë.

**Visare Gorani-Gashi** theksoi se çështja e arsimit apo edukimit është vërtet shumë çështje komplekse, edhe vetëm një grupacion, një qytet, apo një drejtor nuk mundet t'i adresojë të

gjitha nevojat. Rezultatet e PISA-së i dimë, rezultatet e vijueshmërisë së mungesave po i shohim të gjithë, por po i shohim gjithashtu edhe në raportet e tjera, p.sh. një raport i Bankës Botërore ka dalë sot, raporti i cili është i turpshëm, se në shekullin 21 fëmijët tanë për mësimnxënien që përfundojnë shkollën e mesme, me mësimnxënien janë diku në nivelin e klasës 6-7 në raport me fëmijët tjerë. Kisha pasur dëshirë që të gjithë të jemi unik, t'i ndihmojmë proceset e arsimit që kjo situatë të tejkalojet.

**Valbona Petrovci** kërkoi të dijë se sa ka qasje Kuvendi komunal dhe organet e Kuvendit komunal në përzgjedhjen e stafit mësimor, sepse është shumë me rëndësi, pavarësisht që janë çerdhe private. Po ashtu, kishte me qenë mirë të bëhet një angazhim shtesë në lidhje me përzgjedhjen e fëmijëve në shkollat profesionale, që është shume me rëndësi, se kemi shumë më tepër nevojë përfundojnë shkollën e mesme sesa në gjimnaze, pra me ndihmuar shumë fokusimin në shkollat profesionale, me i orientuar fëmijët aty ku ka nevojë ekonomia kosovare.

**Egzon Azemi** kërkoi të dijë se sa është e vërtetë që kryetari Shpend Ahmeti nuk e ka zbatuar rregullën, që fëmijën duhet regjistruar në çerdhen më të afërt prej vendbanimit. Me sa e di, fëmija i Shpend Ahmetit është në shkollën "Xhemail Mustafa", ndërsa ne të gjithë e dimë ku jeton Shpend Ahmeti. Pra, kjo është një shkelje ligjore që potencialisht e ka bërë ai. Diçka që është shumë e rëndësishme dhe duhet të ceket, është edhe çështja e punësimit, që nëse gjithkund tjetër tolerohen këto punësimet partiake, të paktën tek Drejtoria e Arsimit kjo nuk do të duhej të ndodhë. Të ceket edhe çështja e sigurimit privat. Është një diçka jo pozitive, që po ndodhë tash e sa vjet, edhe pse kjo është në mospërputhje me Ligjin për arsim publik, sepse nxënësi i gjimnazit nuk do të duhej të kishte obligim të paguante kompani të sigurimit.

**Halim Halimi** kërkoi një sqarim nga drejtori, për shkak se që nga viti 2015 kemi raste nëpër shkolla që janë ushtrues detyre. Tash për tash i ki 30 e kusur ushtrues detyre, d.m.th. që u ka kaluar mandati gati qe një vit disave. Po ashtu, rrëth përzgjedhjes së mësimdhënësve, a mendoni që komisionet të cilët i formon Kryetari janë profesionale përfundojnë shkollën e kuadrit?

**Adrian Berisha**, tha se do të ishte mirë që Drejtoria e Arsimit të shohë mundësin e hapjes së kurseve përfundojnë e gjuhëve të huaja, ku si shembull konkret mori gjuhën gjermane, që më pas fëmijët mund të futen të punojnë në kompani të ndryshme etj. Ai gjithashtu tërhoqi vërejtjen se në shkollën filllore "Elena Gjika" ka marr shumë fotografi të ndryshme, ku oborri i asaj shkolle është në gjendje shumë të rëndë dhe është e rëndë kur e sheh ashtu at pamje. Aty ka edhe puseta të hapura të kanalizimit. Besoj se do të rregullohet, por është shumë keq kur i sheh ato pamje jashtëzakonisht të këqija të oborrit.

**Shefki Gashi**, lidhur me informatën për arsimin, kryesisht u fokusua në infrastrukturën shkollore, i cili tha se në disa shkolla nuk ka kurrfarë rregulli, kurrfarë pastërtie, kurrfarë rendi shkollar etj.

AiKërkoi që këto parregullsi të përmirësohen.

**Naime Osmani** ngriti shqetësimin rreth punësimit të mësimdhënësve, duke thënë se si është e mundur që të punësohen ata të komunave tjera e të mos punësohen mësimdhënësit të cilët janë banorë po të kësaj komune, gjë kjo që po na kushton. Po ashtu, tha se shkolla e fshatit Besi ka nevojë ta ketë një sallë sportive për nxënësit e kësaj shkolle.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, dha sqarime të nevojshme.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për suksesin dhe rezultatet e arritura të nxënësve në arsimin parauniversitar gjatë vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2018/2019.**

**Pika e dymbëdhjetë**

Informim mbi punën e aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB) dhe NPL "Hortikultura".

Kryesuesi konstatoi prezencën e anëtarëve në sallë dhe në mungesë të kuoromit, kërkoi që mbledhja të ndërpritet.

**Mbledhja u ndërpre në orën 17:00.**

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Agim Kuleta" followed by his typed name "Agim Kuleta" in a smaller font. To the right of the typed name is the official seal of the Prishtina Municipality, which is a circular emblem with the text "PRISHTINA KOMUNA" around the perimeter and "KOSOVË" in the center.